

Rëndësia e një buxheti për shpenzimet

Ne vajzave dhe grave na pëlqejnë aq shumë blerjet, sa që nuk është çudi të hyjmë në dyqane me portofolin plot dhe të dalim pa asgjë në të. Megjithatë nuk jemi vetëm ne femrat që kemi një marrëdhënie të tillë me paratë, edhe gjinia tjetër nuk ngelet pas, sidomos studentët dhe të pamartuarit.

Por shpenzimi i paplanifikuar shpesh të çon në një lëmsh financiar. Buxheti, ose ndryshe një "plan shpenzimi", është një mënyrë për të planifikuar shpenzimin e çdo kartëmonedhe. Plani i shpenzimeve na tregon se ku jemi dhe si mund të arrijmë atje ku duam. Një mënyrë e mirë shpenzimi është të dimë se çdo kartëmonedhë do të përdoret për diçka specifike. Kjo do të jetë një hartë financiare e leverdishme për të mbrojtur financat tona.

Hapat bazë të krijimit të një buxheti (të një plani shpenzimi) janë:

1. Plani i shkruar

Përdorni një plan të shkruar të të gjitha shpenzimeve dhe renditini për nga rëndësia. Sot njerëzit e kanë humbur orientimin midis nevojave dhe dëshirave. Nevojat janë blerjet për të siguruar kërkesat themelore, si: ushqim, veshje, qira shtëpie, vizita mjekësore etj. Dëshirat janë zgjedhje të cilat mund të bëhet vetëm nga fondet e tepërta, pasi janë përmbushur të gjitha detyrimet e tjera. Mbjaj shënim sa para fiton. Fillo me gjërat kryesore, siç janë: e dhjeta (e dhjeta i jepet Perëndisë si një dëshmi që gjithçka që kemi vjen nga Ai (Marku 12:41-44; Malakia 3:8-12), qiraja, pagesa e makinës, faturat e energjisë dhe ujit etj.

2. Rendit shpenzimet thelbësore, jo të rregullta

Shuma e këtyre faturave ndryshon

nga njëri muaj në tjetrin. Ndër këto përfshihen: telefoni, ushqimi, shpenzime për rregullimin e pajisjeve që prishen, karburanti i makinës, ilaçet, transporti publik, veshje dhe këpucë. Ti mund të vendosësh një shumë të caktuar parash, bazuar në përvojat e mëparshme, duke e rrumbullakosur gjithmonë shumën. Rendit shumën të arsyeshme për shpenzime të tjera, si argëtimi, darkat jashtë, palestra etj.

3. Gjej shtesat.

Hap planin e muajit të kaluar për të kontrolluar çfarë shpenzimesh ke lënë jashtë. Me shumë mundësi atje do shohësh gjëra, si: dhuratat, pushimet verore, mirëmbajtja dhe riparimi i makinës etj. Përcakto një kosto vjetore, më pas ndaje këtë shumë në dymbëdhjetë pjesë, shumë që duhet ta heqësh mënjatë çdo muaj nëse do të bësh pushime kur të vijë koha, përndryshe do të mbetesh pa pushime.

4. Llogarit totalët.

Nëse shpenzimet e tua ia kalojnë të ardhurave, do të shohësh se shifra jote del me minus. Mos u shkurajo; ky është fillimi i një procesi të gjatë.

5. Redukto.

Nëse del me minus, atëherë ktheju edhe një herë shpenzimeve mujore dhe shiko se çfarë mund të heqësh. Fillo me shpenzimet jo të domosdoshme. Hiq aq shpenzime, sa ndërsa bën balancin, shpenzimet të jenë më të ulëta sesa të ardhurat. Bëj pyetjen: "A është kjo

një domosdoshmëri? A e pasqyron kjo blerje etikën time si i/e krishterë? P.sh. Zbavitja është një domosdoshmëri e mirë nëse vihet në perspektivën e duhur, por ata që janë në borxh nuk mund të përdorin paratë e të tjerëve për t'u argëtuar.

6. Kurse.

Kursimi i parave rregullisht është shumë i rëndësishëm. Të gjithë ata që jetojnë mbi nivelin e varfërisë kanë aftësi të kursejnë, por shumë nuk arrijnë ta bëjnë, sepse besojnë se shumën është aq e vogël, sa që nuk ia vlen. Edhe në qoftë se ajo është vetëm 500 lekë në muaj, kjo do të zhvillojë një disiplinë kursimi (Fjalët e Urta 21:20).

7. Ndiq planin e shpenzimeve

Kontrollo shpenzimet çdo ditë. Mbjaj shënime dhe gjej mënyra si të bësh një buxhet më të mirë për muajin tjetër. Në fund të muajit, kontrollo shpenzimet aktuale me ato të planifikuarat. Këtë informacion përdore për të bërë planin e shpenzimit të ardhshëm mujor. Edhe sikur të ndihesh pak ngushtë financiarisht këto kohë, merr zemër. Ndërkohë që shlyen borxhet dhe gjen mënyrat për të shkurtuar shpenzimet, do të fillosh të ndiesh një çlirim prej presionit financiar. Sa më herët ta fillosh bërjen e një buxheti, aq më shpejt do të shijosh kënaqësinë e lirisë financiare. Të jetosh me një buxhet nuk është vetëm maturi, por mund të jetë edhe kënaqësi.

Përgatiti Afërdita Dundo